
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.83 /19	Data: 02.05.2019	

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komuna e Istogut shpall:

KONKURS

Drejtoria: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

Titulli i vendit të punës : Teknik i Gjuetisë, Pylltarisë dhe Peshkimit

Numri i Referencës : RN00004774

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Lloji i pozitës: I karrierës

Orari I plotë: 40 orë në javë

Kategoria Funktionale: Niveli tekniko administrativ

Grada: Niveli i koeficient 4.5

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat

Kohëzgjatja e periudhës provuese : 12 muaj.

Qëllimi i vendit të punës: Përmbushje e suksesshme e punëve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve, florës dhe faunës.

Detyrat dhe Përgjegjësit :

1. Ruajtja nga vjedhja, dëmtimi i trungjeve pyjore, Florës dhe Faunës;
2. Kryerja e procedurave rreth qarkullimit të masës drusore dhe pjesa me dokumente përkatëse të transportit të prodhimeve drusore dhe jo drusore;
3. Parandalimi i peshkimit dhe Gjuetisë ilegale dhe mbrojtja e Faunës;
4. Zbatimi i Planeve në mbrojtjen preventive të pyjeve nga zjarret;
5. Përgatitjen e fletëparaqitjeve për veprimet ilegale në pyje, toke pyjore, gjueti dhe peshkim;
6. Kontrollimi i shfrytëzimit të masës drusore të lejuara në ngastrat pyjore për shfrytëzim në pyjet publike, përcjelljen e sezonës së gjuetisë në mënyrë që të parandalohet Gjuetia ilegale sidomos i llojeve të ndaluara me Ligjin për Gjuetinë Nr. 02/L-53;
7. Mbajtja e ditarit të punës dhe librit të cungjeve;
8. Të bashkëpunoi me akteret tjerë në mbledhjen e informatave nga aktivitetet gjatë sezonës së gjuetisë, mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegal, nga zjarret si dhe kryen edhe punë të tjera me kërkesë të Mbikëqyrësit.

Kushtet e pjesëmarrjes në Rekrutim :

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurimit: Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:

- Diploma e Shkollës së Mesme, drejtimi teknik i pylltarisë dhe drejtime të përafërta, 3 vite përvoj pune në profesion;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse që i ndihmon procesit të punës;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit

Afati i konkursit : Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Dokumentet e kërkua : Diploma mbi kualifikimin, dëshmi për përvojën e punës, certifikata që nuk jeni nën hetime origjinal, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (të punësuarit), si dhe certifikata tjera mbi trajnimet. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës “

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen
- Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Menaxheri i Peronelit

Fatmir Bytyçi